

SIMPOZIUM NDËRKOMBËTAR PËR LUMENJTË E EGËR – ISWR 2019 – INFORMACION & DEKLARATË

ALEKO MIHO

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Departamenti i Biologjisë
e-mail: aleko.miho@fshn.edu.al

Në 18 Tetor 2019, në Tiranë u organizua Simpoziumi Ndërkombëtar Shkencor për Lumenjtë e Egër (ISWR 2019), si një bashkëpunim mes Universitetit të Tiranës, me Universitetin e Vjenës, Austri (<http://www.fshn.edu.al/home/ISWR-2019>). Kjo veprimtari është në vazhden e përpjekjeve prej mbi 5 vite që po bën grupimi ynë shkencor (biologë, hidrogjeologë dhe kimistë) nga disa institucione në Shqipëri, Austri dhe Gjermani për të siguruar informacionin e duhur për lumin Vjosë. Qëllimi është të ndihmojmë për të mbrojtur ekosistemet lumore të rrallë me rëndësi europiane, ku lumi i Vjosës dhe degët e tij dallohen ndër të tjerë. Të gjithë këta gjenden sot të kërcënuar nga digat, nga ndërtimi i HEC-eve.

Veprimtaria ishte një ngjarje e veçantë, e ndarë në disa pjesë: një Simpoziium i mirëfillt shkencor, një Mbrëmje publike në kinema, si dhe një Vizitë me varkë nëpër Vjosë me shumicën e pjesëmarrësve. Këtu po bashkëngjis **Deklaratën** përkatëse që u miratua, drejtuar gjithë opinionit shqiptar, por jo vetëm, dhe atij ndërkombëtar, deri në instancat më të larta të vendimmarrjes, vendore dhe europiane.

Cili ishte qëllimi i Simpoziumit për Lumenjtë e Egër?

Termi ‘lumë i egër - *wild river*’ përgjithësisht përdoret për lumenjtë me rrjedhje të lirë, të pa ndërprerë me diga, por edhe pa ndërhyrje të rënda të tjera industriale, portuale, urbane etj., përgjatë gjithë rrjedhës së tyre. Lumenjtë e egër janë sot ndër ekosistemet më të rrezikuara në botë. Edhe ata që kanë mbetur janë nën një kërcënim të rëndë.

Lumenjtë e vëtetë natyrorë janë arteriet e Planetit tonë. Kur ata nuk shqetësohen dhe lihen të rrjedhin të lirë, ata strehojnë larmi të madhe habitatesh me shumë lloje bimore dhe shtazore, sjellin rërë në plazhet tona, prodhojnë ujë të pijshëm me cilësi të lartë dhe ofrojnë shumë shërbime të tjera për njeriun. Fatkeqësisht, shumë lumenj janë shkatërruar ose duke u shkatërruar. Kjo i bën lumenjtë e rrjedhshëm të lirë që kanë mbetur edhe më të rëndësishëm për të gjithë ne.

Disa nga qëllimet konkrete të Simpoziumit ishin: 1) Promovimi i studimeve ndërdisiplinore të lumenjve në gjendjen e tyre natyrore si referencë e përgjithshme për ruajtjen dhe menaxhimin e lumenjve. 2) Promovimi i marrjes së vendimeve ndërdisiplinore për administrimin e peizazheve lumore, mbështetur në prova shkencore. 3) Diskutimi i mjedisit të veçantë

ekologjik dhe biogeografik të lumenjve në Ballkan - me një fokus të veçantë në lumin Vjosë, si një kandidat i parë i mundshëm për një "Park Kombëtar i një Lumi të Egër".

Nga sa më sipër, Simpoziumi mblodhi bashkë shkencëtarë të njohur vendas dhe të huaj (Europa, ShBA, Japoni) për të shqyrtuar çështjet dhe mundësitë për mbrojtjen e lumenjve të fundit të egër në botë. Vëmendja u përqendrua në gjendjen globale të këtyre lumenjve, me një fokus të veçantë në Ballkan. U diskutua mbi gjendjen konkrete, kërcënimet dhe zgjidhjet për menaxhimin dhe mbrojtjen e ujërave. Simpoziumi u përqendrua gjithashtu në Vjosë, si një nga lumenjtë e fundit të egër të mbetur në Europë me të tilla përmasa. Gjithashtu, u diskutua edhe për dëshirën e përbashkët për të hapur një Qendër Shkencore në Tepelenë, si një mundësi për të përmirësuar më tej kërkimin shkencor në lumin Vjosë, në bashkëpunim mes universiteteve shqiptare dhe të huaja.

Pse në Shqipëri?

Pas viteve 1990-të, shumica e lumenjve shqiptarë (gjithsej 3,118 km) u trashëguan thujse të paprekur, kryesisht afër gjendjes natyrore (2,090 km, ose 67%), ose paksa deri në ndryshim të moderuar (636 km, ose 21%). Pra gjendja e tyre e ruajtjes (integriteti i tyre) sipas Natura 2000, konsiderohet shumë e lartë (për 2,209 km, ose 71%), ose e lartë (518 km, ose 17%) (Schwarz, 2012). Duke filluar prej vitit 2007 e deri më sot, numri i përgjithshëm i hidrocentraleve (HEC-eve), të ndërtuar, në ndërtim ose planifikuar të ndërtohen është rritur jashtëzakonisht! Bëhet fjalë për mbi 700 HEC-e (më shumë se 25 HEC-e në 1000 km²) (Artan Rama, 2019), thujse dyfishi krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor! Leje ndërtimore për më shumë se 80 HEC-e janë brenda zonave të mbrojtura (kujtojmë këtu HEC-et në Valbonë, Shebenik, Lengaricë, Lurë etj.), ose zonave potencialisht të mbrojtura, si p.sh. ato mbi lumin Vjosë dhe degët e tij. Për fat të keq, një pjesë jo e vogël e lejeve ndërtimore janë dhënë në vitet e fundit dhe vazhdojnë të jepen ende!

Sot nuk ka diskutim që lumi i Vjosës në të gjithë rrjedhën e tij dhe të degëve të tij është një pasuri natyrore me vlera të mëdha hidrologjike, sedimentologjike, biodiversiteti (larmi llojesh dhe habitatesh lumore etj.). Shumë nga këto vlera janë shqyrtuar në një publikim të veçantë tonin: *The Vjosa, Albania: A riverine ecosystem of European significance* (Acta ZooBot Austria, 155/1, 2018) (<http://www.fshn.edu.al/home/publikime-shkencore>). Përgjatë Vjosës nga delta deri në skajet malore të këtij lumi dhe degëve të tij gjenden mbi 15 habitate lumore që janë me interes europian (Direktiva e Habitatesh - NATURA 2000), kurse 7 habitate kanë vlera të larta floristike (EUNIS, IPA). Këta habitate strehojnë mbi 150 lloje të florës dhe faunës tashmë të njohura, të cilat bëjnë pjesë në Shtojcat e Konventës së Bernës. Është për këto vlera që çështja e Vjosës është sot nën vëmendje edhe të Konventës së Bernës.



Figura 1. Pamje nga rrjedhja e mesme e lumit btë Vjosës (© G. Šubic).

Por lumi i Vjosës dhe degët e tij po kërcënohen nga rreth 45 HEC-e të mëdha dhe të vogla, disa janë ndërtuar, të tjerë janë në ndërtim ose janë të planifikuar të ndërtohen. Ndikimin më i madh pritet ta bëjnë ndërtimi i digave të planifikuara në Poçem dhe Kalivaç, të cilat do të ndërpresin përfundimisht rrjedhjen e lirë të lumit Vjosë, një ndër tiparet kryesore të tij si një lumë i egër, i vetmi në Europë, duke përjashtuar Rusinë.

Kujtoj këtu që vetë raportet e Progresit të KE kanë theksuar në mënyrë të përsëritur kërkesën për të mbrojtur lumenjtë nga planet ndërtimore të HEC-eve (prill 2015, prill 2016, nëntor 2016 dhe shkurt 2017), si dhe në veçanti mbrojtjen e lumit të Vjosës. Qeveria shqiptare ka bërë gjithmonë të heshturin dhe vepruar në të kundërt!

Deklarata e Simpoziumit: Ruani lumenjtë e egër

Lumenjtë që rrjedhin lirshëm janë ndër ekosistemet më të vyer në tokë, duke siguruar një gamë të gjerë shërbimesh shoqërore dhe ekonomike, dhe përfitime për njeriun. Gjatë 50 viteve të kaluara, shumë lumenj janë përkeqësuar fuqimisht; brenda Bashkimit Europian, për shembull, vetëm 4 nga 10 lumenj janë në një gjendje të mirë ekologjike – dhe shumica e tyre janë të vendosura në zona të thella dhe malore. Në të gjithë Europën, ndërtimi në të kaluarën dhe në vazhdim i digave për HEC-e është shkaku kryesor i rënies së pashembullt të jetës së ujërave të ëmbla dhe funksioneve të ekosistemit.

Lumenjtë në Ballkan mbeten ende në një gjendje të mirë të jashtëzakonshme; në të njëjtën kohë ata janë pika të nxehta me rëndësi globale për jetën e ujërave të ëmbla. Sidoqoftë, rreth 3,000 hidrocentrale të rinj janë në planifikim, duke kërcënuar këtë trashëgimi natyrore unike.

Lumi Vjosë në Shqipëri - i shquar për gjendjen e tij gati-natyrore - është një trashëgimi natyrore me rëndësi europiane, në të vërtetë e kërcënuar nga projektet e digave. Vlera ekonomike e këtyre digave është e diskutueshme; megjithatë, pasojat ekologjike dhe sociale do të jenë të rënda dhe të pakthyeshme. Në të njëjtën kohë, standardet në përmbushjen e direktivave europiane të mjedisit janë injoruar kryesisht.

Duke qenë të vetëdijshëm për vlerën dhe rëndësinë e madhe të lumenjve të fundit të rrjedhshëm të egër dhe të lirë të botës, duke ditur për kërcënimet e jashtëzakonshme me të cilat ata përballen, ne kërkojmë nga përfaqësuesit e Komisionit Europian dhe anëtarët e Parlamentit Europian të sigurojnë në mënyrë të vazhdueshme:

- Mbrojtjen e lumenjve që kanë mbetur të paprekur në Europë nga dëmtimi, devijimi, kanalizimi ose ndotja;
- Ripërtëritjen e atyre lumenjve dhe përrenjve që janë ndikuar në të kaluarën;
- Zbatimin e Direktivës Europiane të Kornizës së Ujit, Direktivave EIA dhe Natura 2000 në vendet e BE-së, si dhe në shtetet që pranohen në BE.

Në mënyrë të veçantë, ne kërkojmë nga liderët politikë të vendeve të Ballkanit që t'i kushtojnë vëmendje të veçantë lumenjve të tyre, pasi ato formojnë shtyllat kurrizore kulturore dhe natyrore të të gjithë rajonit. Për më tepër, ekziston një mundësi unike për zhvillimin ekonomik në këtë rajon duke mbrojtur jetën e tyre të pasur kulturore dhe natyrore. Prandaj, ne urgjentisht i bëjmë thirrje drejtuesve:

- Të ndjekin rreptësisht standardet e BE-së dhe direktivat e saj; veçanërisht për të monitoruar me kujdes dhe për të përmirësuar cilësinë dhe standardet e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis në përgatitjen e projekteve që ndikojnë në lumë.
- Të krijojnë dhe zgjerojnë zonat e mbrojtura përgjatë lumenjve, si parqe kombëtare, rezerva natyrore, etj.

Në lidhje me Vjosën, ne i kërkojmë Qeverisë shqiptare:

- Të respektojë dhe zbatojë standardet e Bashkimit Europian në procesin e planifikimit të digave (EIA, WFD, Direktivën Natura 2000) në Vjosë, si dhe përgjatë të gjithë lumenjve në Shqipëri;
- Të garantojë zbatimin e standardeve ndërkombëtare në menaxhimin e lumenjve;
- Të mbrojë lumin Vjosë dhe degët e tij në të gjithë gjatësinë në Shqipëri dhe të mbështetë vizionin për krijimin e Parkut Kombëtar të parë të Lumit të Egër të Europës.
- Të mbështetë programe kërkimore për të vlerësuar vetitë strukturore dhe funksionale dhe vlerat e lumit, si një trashëgimi natyrore me rëndësi europiane.